



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/263

Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 261-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e 262-të Elektronike/Korresponduese e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/263
Datë: 27.06.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, dhe Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 4,000,000€ (katër milionë euro) për zbatimin e Masës 4.5 "Mbështetja e Mërgatës" të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet buxhetore, sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e projektit (00098) të organizata buxhetore dhe programi përkatës.
4. Autorizohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Byronë Kosovare të Sigurimit, sipas fushave të përgjegjësisë institucionale, për mbulimin e plotë të obligimeve të primit të sigurimit kufitar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për të gjitha automjetet që janë subjekt i policës kufitare dhe vijnë në Kosovë deri në fund të vitit 2025, sipas përkufizimeve që përcaktohen në Memorandumin e Bashkëpunimit.
5. Nga shuma e paraparë në pikën 1. të këtij Vendimi, do të mbulohen edhe obligimet e bartura nga Memorandumi i Bashkëpunimit i vitit 2024.
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa fillimi i mbulimit të sigurimit kufitar dhe lëshimit të policës kufitare pa kosto për bashkatdhetarët dhe të huajt, sipas pikës 1. të këtij Vendimi përcaktohet me Memorandumin e Bashkëpunimit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete buxhetore për mbështetje të Këshillit Kombëtar Shqiptar, sipas Memorandumit të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Kombëtar Shqiptar, në vlerë prej 626,400.00€ (gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind euro) për mbështetjen e arsimit dhe lobimit institucional për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, duke përfshirë bursa për studentë, mbështetje për nxënësit dhe financim të aktiviteteve lobuese dhe avokuese në nivel ndërkombëtar.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përdoren mjetet nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës" me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi do të transferohen në Llogari bankare në emër të Këshillit Kombëtar Shqiptar HALKBANK Iban: RS 35155007040000131481.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr.08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Hanit të Elezit:
 - Rindërtimi i Fushës së Futbollit, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Rregullimi i pronësisë për Fabrikën e Ujit, Zona Kadastrale Dermjak, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Ndërtimi i Qendrës për Kulturë dhe Rini, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Zgjerimi i rrugës pranë Terminalit Doganor, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është Raporti i vlerësimit, i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme /Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi, në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ia dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike ka të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, subjekti kërkues - Komuna e Hanit të Elezit do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi, konform legjislacionit në fuqi.
8. Subjekti Kërkues - Komuna e Hanit të Elezit do t'i paguajë plotësisht të gjitha obligimet e tjera financiare, që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit, si dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë, në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 9, 10 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr.08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme Pasuri Shoqërore "Kombinati i Drurit" Ferizaj; Seksioni i Pyjeve Gjilan, Zona Kadastrale Përlepnice, që menaxhohet dhe administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, shpronësimi i të cilës është i nevojshëm për realizimin e projektit "FLOWS", i financuar nga Banka Botërore dhe Ndërmarrja Rajonale për Ujësjiellës "Hidromorava" Sh. A., sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit, që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, ta shpallë atë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi, apo cilëndo pjesë të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ndërmarrja Rajonale për Ujësjiellës "Hidromorava" Sh. A.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/263
Datë: 27.06.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 3. të Ligjit Nr. 08/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komitetit Ndërminstoror për shëndetin njerëzor, shtazor dhe mjedisor "Një Shëndet" me përbërje si në vijim:
 - 1.1. Dr. Hajrullah Fejza, Ministria e Shëndetësisë, kryesues;
 - 1.2. Znj. Zana Haraqija, Ministria e Shëndetësisë, anëtare;
 - 1.3. Znj. Fisnike Kelmendi, Ministria e Shëndetësisë, anëtare;
 - 1.4. Z. Sadik Heta, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.5. Z. Bafti Murati, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 1.6. Znj. Leonora Durmishi, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtare;
 - 1.7. Z. Labinot Zogjani, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.8. Dr. Pranvera Kaçaniku, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtare;
 - 1.9. Dr. Donjeta Hajdari, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtare;
 - 1.10. Dr. Ergyl Binçe, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtar;
 - 1.11. Prof. Valbona Zhjeqi, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtare;
 - 1.12. Prof. Fadil Musa, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 1.13. Dr. Arben Vishaj, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, anëtar;
 - 1.14. Dr. Greta Lila, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, anëtare;
 - 1.15. Dr. Shaban Osmanaj, Ministria e Shëndetësisë, anëtar;
 - 1.16. Dr. Antigone Muharremaj-Bytyçi, Forca e Sigurisë së Kosovës, anëtare;
 - 1.17. Znj. Era Pireva, Sekretari administrative, anëtare.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit janë në shtojcën 1. të këtij Vendimi.
3. Mandati i këtij komisioni është dy (2) vjeçar.
4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

SHTOJCA 1. Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mandati kryesor i Komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor është të zhvillojë veprimtarinë e vet në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e shëndetit publik nr. 08/L-200.
- Të sigurojë bashkëpunim të strukturuar dhe të qëndrueshëm ndërmjet sektorit të shëndetësisë, shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit;
- Të këshillojë dhe të rekomandojë ministrin për çështjet përkatëse nga fusha shëndetësore, veterinare, mjedisore dhe fusha të tjera relevante;
- Të koordinojë ndërhyrjet ndërsektoriale për identifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, veçanërisht atyre zoonotike dhe gripit që paraqesin rrezik për shëndetin publik;
- Të koordinojë dhe të rekomandojë masat dhe politikat që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit;
- Komiteti për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet” me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara mund të thërrasë edhe ekspertë nga fushat përkatëse varësisht nga situata epidemiologjike.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19/A të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në ndërmarrjen shoqërore "Çeliku", në shumë prej 6,405 € (gjashtë mijë e katërqind e pesë euro).
2. Mjetet buxhetore merren nga kodi i pranimit të këtyre të hyrave dhe nga llogaria kryesore e BRK-së dhe kthehen në llogaritë e ndërmarrjeve shoqërore, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, me qëllim që ndërmarrjet shoqërore të kenë mjete të mjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat kreditore, apo për t'i mbuluar shpenzimet e likuiditetit, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 14, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve buxhetore në shumë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë eurosh), në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me kod 212, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e "Shpenzimeve kapitale", konkretisht nga projekti kapital "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal" me kod 15633 në 1 (një) projekt kapital në përputhje me 1 (një) marrëveshje të mirëkuptimit për projektin kapital të nënshkruar nga Ministri i MAPL-së dhe Kryetari i Komunës së Pejës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti kapital "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal" me kod 15633, në këtë projekt të ri "Ndërtimi i Ndriçimit Publik në fshatin Nakell dhe fshatin Gorazhdec të Komunës së Pejës", në vlerë prej 50.000,00€ (pesëdhjetë mijë eurosh).
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 28, paragrafit 4. të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Konsoliduar Vjetor për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Subjektet e Sektorit Publik për vitin 2024.
2. Pjesë e këtij Vendimi është Raporti i përmendur në pikën 1.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/263

Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Lituanisë për Ripranimin e Personave pa Autorizim.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/263

Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2026.
2. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës që pjesën e implikimeve financiare të Planit nga pika 1. e këtij Vendimi, ta harmonizojë me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës, për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni *Ad-hoc* i Pranimit për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Naim Gashi, Drejtor në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, kryesues;
 - 1.2. Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - 1.3. Arsim Tahiri, Drejtor i Shërbimit Sprovues të Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Arta Nuredini, Menaxhere e Burimeve Njerëzore, anëtare;
 - 1.5. Besard Belegu, Ekspert i jashtëm.
2. Obligohet Komisioni që t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e tij, siç parashihet me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294 dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/263
Datë: 27.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49, nenit 50 dhe nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 38 të Ligjit Nr. 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, të nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa për huamarrje deri në dhjetë milionë € (10,000,000.00 euro) për "Infrakos Sh. A.", për qëllime të likuiditetit të ndërmarrjes, subjekt i aprovimit nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.
2. Obligohet Thesari që për huadhënien ndaj ndërmarrjes publike të bëjë transferet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrat kontabël në kuadër të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Financave të Kosovës.
3. Mjetet e huadhënies sipas këtij Vendimi, përdoren vetëm për qëllimin e miratuar dhe nuk janë subjekt i asnjë kufizimi, pretendimi dhe detyrimi nga palët e treta.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë